



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2553 / Prot
1

Tiranë, më 07/10 /2020

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE _____
DREJTORISË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK _____

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr.11, datë 03.03.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar me Urdhërin nr. 107, datë 13.08.2020 dhe shkresës nr.209 prot, datë 30.09.2020 “Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele” të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Korçë, protokolluar në AKPA me nr.2553 prot, datë 05.10.2020,

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të lëvizjes paralele për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik, në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Korçë, për pozicionet:

1. 1 mësimdhënës të formimit teorik-praktik për kursin Manikyr Pedikyr
2. 1 mësimdhënës të formimit teorik-praktik për kursin Riparim celularësh

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Korçë

Aplikanti për mësimdhënës të formimit teorik-praktik, në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Korçë, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojnë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik, si vijon:

- a) të ketë minimalisht diplomë nga një shkollë e mesme profesionale/ pas të mesëm, kualifikim profesional mbi një vit në fushën/profesionin që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të formimit profesional;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Korçë brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 08.10.2020.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Korçë të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionet:

1. 1 mësimdhënës të formimit teorik-praktik për kursin Manikyr Pedikyr
 2. 1 mësimdhënës të formimit teorik-praktik për kursin Riparim celularësh
- në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Në rastin kur krijohet një vend i lirë pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Korçë, brenda 5 ditëve pune shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Drejtorisë Rajonale e Formimit Profesional Publik Korçë, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Korçë.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

